

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot me datë 22 Maj 2020 (dymijë e njëzet), palët e mëposhtme me vullnetin e tyre të lirë dhe mbështetur në Vendimin Nr: 2020-05-01 datë 22.05.2020 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë BeeWise Shpk, Shoqëri Tregtare e regjistruar pranë QKB me NIPT: L82320048R, me seli në adresën Rruga Astrit Losha, Unaza e Re, Tiranë, vendosën si më poshtë.

Palët :

1. **Z. Mehmet Zirek** i biri i İrfan, i datëlindjes 21.07.1965, lindur në Turqi dhe banues në Tiranë në adresën, Rruga Thoma Koxhaj, Pallati 519 K3 A1, identifikuar me pasaportë me numër U13489735 dhe me numër personal 16081790990, i cili këtu e në vazhdim do të quhet **Shitësi**.
2. **Z. Armand Shkurta** i biri i Hasis-it, i datëlindjes 16.06.1983, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë në adresën, Rruga Gjergj Legisi, Blloku Gintash, Pallati P, Ap.9, identifikuar me kartë identiteti me numër personal I30616190U, i cili këtu e në vazhdim do të quhet **Blerësi**

Referuar akteve të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë Tregtare **BeeWise Shpk** në vendimin e saj Nr: 2020-05-01 date 22.05.2020 ka vendosur lejimin e transferimit me anë të shitjes, të 15% të kuotave të kapitalit të shoqërisë nga Z. Mehmet Zirek tek Z. Armand Shkurta. Shitësi i cili është ortak i 15% të kuotave në Shoqërinë Tregtare BeeWise Shpk, deklaroi se me vullnet të lirë dhe të plotë i shet Blerësit, Z. Armand Shkurta 15% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë me çmimin 1.500 (Njëmijë e pesëqind) Lek.

Edhe Blerësi Z. Armand Shkurta deklaroi se pranon të blejë 15% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë BeeWise Shpk nga Shitësi Z. Mehmet Zirek me çmimin 1.500 (Njëmijë e pesëqind) Lek dhe nga ky moment njihet si zotërues ekskluziv i pakontestueshëm për kuotat e mësipërme të transferuara.

Që nga ky moment Z. Armand Shkurta bëhet zotërues i 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe Z. Mehmet Zirek largohet nga pjesëmarrja si ortak i shoqërisë.


Ortakë të shoqërisë BeeWise Shpk janë Z. Bardhyl Blinishta, Z. Armand Shkurta dhe Z. Ozgen Fidel Polat.

Kjo kontratë depozitohet pranë QKB Tiranë për kryerjen e ndryshimeve përkatëse.

Kjo kontratë pasi u lexua mes paleve dhe u gjet konform vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë, palët pranuan t'a nënshkruajnë atë si më poshtë.

Shitësi


Z. Mehmet Zirek



Mehmet Zirek

Blerësi

Z. Armand Shkurta



Armand Shkurta